Shëndeti

Sistemi shëndetësor
Sigurimi shëndetësor dhe i aksidentit
Furnizimi shëndetësor
Shtatzënësia / Lindja
Shëndeti psiqik

Sistemi shëndetësor

Sistemi shëndetësor në Zvicër është i organizuar shumë mirë. Të gjithë banorët janë plotësisht dhe detyrimisht të siguruar ndaj aksidentit dhe sëmundjes. Një numër i madh i ordinancave, barnatoreve, dhe spitaleve e garantojnë funksionimin e shërbimit mjekësor.

Sistemi i sigurimeve

Në Zvicër të gjithë banorët janë të detyruar të sigurohen daj aksidentit dhe sëmundjes. Kush vendoset këtu, është i detyruar ta lidhë sigurimin në tre muajt e parë mbas hyrjes në Zvicër. Është e detyrueshme që fëmijët të sigurohen mbrenda tre muajve pas lindjes. Shërbimet e sigurimit obligativ janë të rregulluarra me ligj. Të gjithë të siguruarit kanë të drejta të barabarta të trajtimit mjekësor.

Financimi

Sistemi shëndetësor zviceran financohet sëbashku nga shteti (Federata, Kantonet, Komunat), punëdhënësit dhe personat privat. Personat privat e paguajnë vetëm shumën mujore të sigurimit për trajtim në rast sëmundje dhe sigurimin në rast aksidenti. Kjo shumë përcaktohet çdo vit dhe është e ndryshme mvarësisht nga Kantoni. Kush sëmuret ose ka aksident, duhet veç kësaj të marr pjesë në shpenzime shtesë (shuma e vetërezervuar dhe Franchise, Franchise und Selbstbehalt). Mirëpo këtu është e përcaktuar shuma maksimale vjetore.

Përkthimet

Nuk është e thjeshtë në qoftë se duhet të komunikoni në një gjuhë të huaj me mjekët, farmacistët apo motrat medicionale. Për këtë arsye disa spitale ofrojnë përkthime falas nga përkthyesit ndërkulturor të cilët janë të shkolluar enkas për këtë. Pacientët duhet me kohë vetë të informohen për këtë. Përkthyesit munden të porositen edhe për vizita mjekësore dhe situata të tjera. Mirëpo atëherë duhet të paguhen vetë.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-glarus.ch/sq/shendeti/sistemi-shendetesor

Sigurimi shëndetësor dhe i aksidentit

Kush banon në Zvicër, duhet ta ketë sigurimin për aksident dhe sigurimin shëndetësor. Këto sigurime private i heqin shpenzimet në rast aksidenti, sëmundje apo shtatzënësie. Të dy sigurimet duhet të lidhen në tre muajt e parë pas hyrjes në Zvicër.

Sigurimi shëndetësor për trajtim mjekësor (sigurimi bazë)

Të gjithë banorët në Zvicër duhet patjetër ta lidhin vetë sigurimin shëndetësor (sigurimin bazë, Grundversicherung). Kush vendoset në Zvicër, ka për këtë tre muaj kohë. Nëse sëmureni gjatë kësaj kohe, shpenzimet mbulohen nga sigurimi me prapaveprim. Sigurimi bazë ofrohet prej shumë sigurimeve shëndetësore private (Krankenkassen). Përzgjedhja e sigurimit shëndetësor është e lirë. Sigurimet shëndetësore janë të detyruara ti pranojnë të gjithë personat të cilët jetojnë në Zvicër. Të siguruarit e paguajn një shumë mujore (premin). Këto shuma janë të ndryshme mvarësisht nga sigurimi shëndetësor dhe lloji i sigurimit, për këtë arsye ia vlenë të krahasohen ofertat. Sigurimet shëndetësore mund të ndërrohen vetëm njëherë në vit, gjithëmonë deri në fund të nëntorit, për vitin pasardhës. Sigurimi bazë nuk i merr shpenzimet vetëm kur sëmureni, ai paguan edhe gjatë shtatëzënësisë dhe lindjen. Shërbimet janë të rregulluara me ligj. Kujdes: Shpenzimet për mjekimin e dhëmbëve ose për syze, sipas rregullit, duhet të paguhen vetë ose mbulohen nga sigurimit shtesë vullnetarë.

Sigurimi ndaj aksidenteve

Të punësuarit janë të siguruar nga punëdhënësi automatikisht kundër aksidenteve gjatë punës dhe kohës së lirë, nëse ata punojnë më shumë se 8 orë në javë. Kush punon më pak, nuk është i siguruar kundër aksidenteve gjatë kohës së lirë dhe duhet të përkujdeset vetë për sigurimin ndaj aksidentit. Kjo vlenë edhe për ndërmarrësit e pavarur dhe të gjithë personat të cilët nuk janë në marrëdhënie pune. Personat të cilët nuk janë të punësuar duhet vetë të sigurohen kundër aksidentit te sigurimi shëndetësor i tyre. Ndërmarrësit e pavarur mund të sigurohen kundër aksidentit edhe te sigurimet e tjera. Të siguruarit duhet ta paguajn vetë shumën mujore (premin). Të punësuarëve kjo shumë ju zbritet direkt nga paga.

Zbritja e shumës (premisë)

Kush nuk është në gjendje ta paguaj vetë sigurimin shëndetësor, nën rrethana të caktuara e ka të drejtën për zbritjen e shumës për sigurimin bazik (Prämienverbilligung). Për ta marrë zbritjen, duhet të shtrohet kërkesë me shkrim deri me 31. Janar të vitit përkatës. Nëse miratohet kërkesa, në vitin e ardhshëm paguhet më pak premi (shumë më e vogël). Administrata tatimore kantonale ju informon për zbritjen e premisë (shumës) dhe i pranon kërkesat përmes internetit (online).

Sigurimi plotësues ndaj sigurimin bazë

Si plotësim ndaj sigurimit obligativ bazë, vullnetarisht mund të lidhen sigurime të ndryshme plotësuese (Zusatzversicherung). Këto sigurime i mbulojnë shpenzimet të cilat nuk mbulohen nga sigurimi bazë, p.sh, mjekimi i dhëmbëve. Sigurimet plotësuese ofrohen pothuajse prej të gjitha sigurimeve shëndetësore. Sigurimet shëndetësore mund të vendosin vetë, se a dëshirojnë ta sigurojnë dikë apo jo dhe ato për këtë mund të vendosin kushte.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-glarus.ch/sq/shendeti/sigurimi-per-semundje-dhe-aksident

Furnizimi shëndetësor

Kush sëmuret apo ka aksident, në të shumtën e rasteve, sëpari duhet të shkoj te mjeku familjar. Te sëmundjet e apo aksidentet e lehta nund të merret ndihmë edhe në barnatore. Vetëm në rastet emergjente vërtetë të rënda duhet të shkohet direkt në spital.

Barnatoret

Barnatoret shesin barna me udhëzim (recept) të mjekut dhe të gjitha barnat e tjera. Në rast sëmundje të lehtë sygjerohet sëpari të shkohet në barnatore. Farmacistët janë të shkolluar mirë. Ata i këshillojnë me kompetencë klientët e tyre. Në raste emergjente barnat shpërndahen nëpërmjet shërbimit emergjent të mjekësisë familjare.
Shërbimi emergjent i mjekësisë familjare Glarus Nord (24h) 0844 33 66 33
Shërbimi emergjent i mjekësisë familjare Glarus (24h) 0844 44 66 44
Shërbimi emergjent i mjekësisë familjare Glarus Süd (24h) 0844 55 66 55

Mjekja familjare / Mjeku i fëmijëve

Në Zvicër shumë persona e kanë mjekun familjar (Hausarzt). Ai e njeh historinë personale të sëmundjes dhe në rast problemesh shëndetësore është personi i parë kontaktues. Për fëmijë ekzistojnë mjekët e fëmijëve. Nëse është e nevojshme mjeku i dërgon pacientët te mjekët specialist ose në spital. Drejtëpërsëdrejti në spital do të duhej të shkohet vetëm në rastet emergjente të rënda.
Për të gjitha rastet e tjera emergjente, jashtë orarit të punës të ordinancave mjekësore, ekziston për seicilen Komunë numri emergjent. Ai është 24 orë i hapur.
Shërbimi emergjent i mjekësisë familjare Glarus Nord (24h) 0844 33 66 33
Shërbimi emergjent i mjekësisë familjare Glarus (24h) 0844 44 66 44
Shërbimi emergjent i mjekësisë familjare Glarus Süd (24h) 0844 55 66 55

Mjeku i dhëmbëve (Dentisti)

Mjekimi i dhëmbëve sipas rregullit duhet të paguhet vetë. Mirëpo ekziston mundësia për ta lidhë sigurimin shtesë i cili e mbulon trajtimin e dhëmbëve. Fëmijët të cilët shkojnë në shkollë njëherë në vit e kanë të drejtën për kontroll falas të dhëmbëve . Informatat për këtë i jep shkolla.

Spitali / Stacionet e emergjencës

Kur dikush duhet të shkoj në spital, në shumicën e rasteve lajmërohet nga mjeku. Përjashtim bëjnë aksidentet e rënda. Në rastet e tilla duhet shkohet direkt në stacionin e spitalit për raste emergjente. Në rast rreziku për jetë ose pacienti duhet të merret nga ambulanca, duhet të thirret në numrin emergjent 144. Te rastet emergjente më pak të rënda është përgjegjës mjeku familjar.

Përkujdesja në shtëpi

Të sëmurit ose personat të cilët kanë nevojë për përkujdesje, të cilëve ju nevojitet përkujdesje në shtëpi, mund t`i marrin shërbimet nga shërbimi i jashtëm për përkujdesje shëndetësore (Spitex). Specialistët shkojnë në shtëpi te pacientët për përkujdesje ndaj tyre ose për t'iu ndihmuar në punët e shtëpisë. Kjo ofertë ju drejtohet personave të cilët për shkak të sëmundjes, aksidentit, pleqërisë, komplikimeve gjatë shtatzënësisë apo mbas lindjes, kanë nevojë për mbështetje. Shpenzimet mbulohen pjesërisht nga sigurimi bazë (Grundversicherung).

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-glarus.ch/sq/shendeti/sherbimit-mjekesore

Shtatzënësia / Lindja

Gratë shtatzëna nuk janë të detyruara t`i paguajn vetë kontrollat e nevojshme. Edhe shpenzimet e lindjes i mbulon sigurimi bazë. Para dhe pas lindjes prindërit mund të marrin këshilla falas.

Shërbimet për shtatzënësi dhe lindja

Shërbimet medicinale në lidhje me shtatzënësinë dhe lindjen mbulohen nga sigurimi shëndetësor bazë (Grundversicherung). Këtu bëjnë pjesë kontrollat e rregullta para lindjes, lindja vetë dhe përkujdesja e nevojshme pas saj. Gratë shtatzëna duhet me kohë të drejtohen te mjeku ose mamia. Spitalet dhe mamit ofrojnë edhe kurse për parapërgaditjen e lindjes (Geburtsvorbereitungskurse). Ka edhe kurse speciale për migrantët. Lindja mund të bëhet në spital, në një shtëpi lindjeje ose në shtëpi.

Pas lindjes

Në Zvicër është e zakonshme që mbas lindjes prindërve t'iu ipen këshilla. Për këtë ka zyra për këshillimin e nënave dhe baballarëve (Mütter und Väterberatungsstelle). Këto zyra ofrojnë informata për zhvillimin, ushqimin dhe përkujdesjen ndaj foshnjes. Këshillimet janë falas. Për kontrollat e mëtejshme të nevojshme për nënën dhe foshnjen ju informojnë mjeku ose mamia. Është shumë e rëndësishme, që fëmija më s`voni tre muaj pas lindjes të sigurohet kundër sëmundjeve dhe aksidentit (sigurimi bazë, sigurimi ndaj aksident). Më s`miri është që kjo të bëhet që para lindjes.

Vaksinimi

Është e preferueshme, që fëmijët me kohë të vaksinohen kundër disa sëmundjeve. Vaksinimi nuk është i detyrueshëm. Shpenzimet për vaksinimet e propozuara, sipas rregullit, i merr sigurimi shëndetësor bazë. Mjekja e fëmijëve ose zyra për këshillimin e nënave dhe baballarëve ju informojnë për vaksinim.

Ndërprerja e shtatzënësisë

Në Zvicër është e lejuar ndërprerja e shtatzënësisë në tre muajt e parë të shtatzënësisë. Pas mbarimit të javës së 12-të të shtatzënësisë aborti është i mundshëm vetëm atëherë kur rrezikohet shëndeti fizik apo psiqik i gruas. Vlerësimin e kësaj duhet patjetër ta bëj mjeku. Kush e mendon ta ndërpres shtatzënësinë, ka të drejtë për këshillim falas. Gratë e reja nën moshën16 vjeçare duhet të drejtohen për këshillim pranë zyrës së specializuar. Shpenzimet për të gjitha shërbimet mjekësore mbulohen prej sigurimit shëndetësor bazë.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-glarus.ch/sq/shendeti/shtatzenesia--lindja

Shëndeti psiqik

Në Zvicër nuk bëhet dallim në mes sëmundjeve psiqike dhe fizike. Sigurimi bazë e paguan trajtimin e sëmundjeve psiqike te njerëzit e specializuar si dhe qëndrimin në klinikë.

Mbështetja (ndihma) dhe këshillimi

Për situata të vështira personale apo familjare në Zvicër ka shumë persona të specializuar të cilët ndihmojnë më tej. Sigurimi shëndetësor bazë (Grundversicherung) e paguan trajtimin e sëmundjeve psiqike nga specialistët e çertifikuar me ligj si psikiatret dhe psikiatrit. Qëndrimet në klinikë paguhen poashtu. Kush ka probleme, mundet falas t'iu drejtohet Zyrave për këshillim anonim. Kështu këshillon Dora e Zgjatur (Dargebotene Hand) përmes telefonit, E- Mailt apo chat (telefon 143, www.143.ch). Poashtu munden të ndihmojnë edhe mjekja apo mjeku familjar. Kur një person është akut i rrezikuar, ta dëmtoj veten ose dikë tjetër, duhet të veprohet shpejt. Në këto raste urgjente ndihmon policia (telefoni 117).

Fëmijët dhe rinia

Për të rinjët me probleme psiqike shërbimi psikiatrik ambulant i fëmijëve dhe të rinjëve (KJDP) është vendi (zyra) i parë i rëndësishëm për këtë. Edhe prindërit, të cilët brengosen për fëmijët e tyre, mund të lajmërohen aty. Mbështetje anonime falas për fëmijë dhe të rinjë ofrojnë thirrja emergjente për fëmijë (Kindernotruf) përmes telefonit, E-Mal apo Chat (Tel.147, www.147.ch). Për raste emergjente psikiatrike te fëmijët dhe të rinjët është në dispozicion ambulanca qendrore për fëmijë dhe të rinjë (ZAJK) përgjatë 24 orëve nën numrin e telefonit 056 62 21 20.

Sëmundjet e mvarësisë

Te sëmundjet e mvarësisë ju ndihmon më tutje Qendra e këshillimit dhe terapisë Sonnenhügel. Ajo ofron mbështetje dhe këshillim në besim falas. Edhe kur brengoseni për familjarët dhe personat e afërm, mund t`i kontaktojni qendrat (zyrat) për këshillim. Si sëmundje të mvarësisë nuk numrojnë vetëm mvarësia ndaj alkoholit ose drogës. Edhe te mvarësitë e tjera si mvarësia e lojës, blerjes apo internetit dhe pengesat në të ushqyer ju ndihmojnë më tutje zyrat për këshillim ndaj varësisë. Pyetjet mund të shtrohen edhe përmes E-Mailit.

Traumatizimi

Kush gjatë jetës ka përjetuar gjëra të këqija dhe nuk ka mundur ti tejkaloj ato, do të duhej të marr ndihmë. Sepse traumat janë sëmundje të cilat duhet të merren seriozisht. Përveç ofertave për këshillim dhe ndihmë për probleme dhe sëmundje psiqike ka edhe qendra të specializuara për trajtimin e viktimave të luftës dhe torturës.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-glarus.ch/sq/shendeti/shendeti-psiqik